

STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT I SHOQËRISË AKSIONARE “ATLAS FABIANNE” SH.A.

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia dhe adresa elektronike

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, më 17.12.2021 unë, themeluesi, Z.Ben Petani kam krijuar një shoqëri aksionare me emrin “ATLAS FABIANNE” SHA.

1. Emri i Shoqerise eshte “ATLAS FABIANNE” SHA, e pasuar ne menyre te pandashme nga shkurtimi "Sh.A.", qe perfaqeson formen e saj ligjore, ne vijim referuar si "Shoqeria".
2. Shoqeria eshte nje person juridik Shqiptar qe ka formen ligjore te shoqerise aksionare me oferte private, me nje nivel administrimi, sipas parashikimeve te Ligjit Nr.9901, date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar.
3. Aksionaret e Shoqerise gezojne pergjegjesi te kufizuar deri ne kufirin e kontributit te tyre ne kapitalin e Shoqerise, te perfaqesuar nga aksionet.
4. Ne te gjitha dokumentat, faturat, reklamat, dhe publikimet e leshuara nga Shoqeria, pavaresisht mjetit te transmetimit, emri i Shoqerise do te paraprihet ose do te ndiqet nga fjalet si ne vijim:
 - a. fjalet "Shoqeri Aksionare" ose "Sh.A.",
 - b. numri i saj unik i indentifikimit (NUIS),
 - c. selia e saj,
 - d. fakti nese Shoqeria eshte ne likuidim, nese eshte rasti.

Themeluesi, aksionari i vetëm shoqërisë është:

- **Z. Ben Petani**, shtetas shqiptar, lindur në Himare, Shqiperi, më 22.03.1967, dhe banues ne Tirane, person madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, i pajisur me nr. Letërnjoftimi 033125097 dhe nr. Personal G70322160R, me adrese banimi ne Tirane, Rruga e “Kavajes”, nd.0, Njesia Administrative Nr.10, Tirane.

Neni 2

Objekti

Shoqëria “ATLAS FABIANNE” SHA, do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:



- Prodhim, transmetim, shperndarje, furnizim dhe tregtim energji elektrike Hidrocentrale. Prodhim, transmetim, operim dhe tregtim te energjise elektrike nga burimet e energjise rinovabel. Prodhim transmetim dhe tregtim energjie elektrike nga termocentralet. Projektim, ndertim dhe montim centralesh elektrike te fuqive te ndryshme. Import - eksport makineri dhe pajisje elektrike per hidrocentrale dhe centrale elektrike te fuqive te ndryshme. Ndertim stacionesh linjash transmetues dhe nenstacionesh elektrike. Mirembajtje linjash dhe riparime nenstacionesh centralesh elektrike. Ndertim digash, tunelesh dhe argjinatura hidrocentralesh si dhe cdo veper tjeter ne funksion te prodhimit - transmetimit dhe tregtimit te energjise elektrike. Prodhimin e furnizimin ne sektorin e energjise elektirke, nepermjet kryerjes se investimeve ne kete fushe. Ne fushen e import eksportit, me shumice e pakice, per importimin e te gjithave pajisjeve dhe lendeve te para dhe ndihmese, qe kerkohet per realizimin e veprimtarise se sipercituar.
- Prodhimi i energjise elektrike nga burimet e rinovueshme. Ndertimi i hidrocentraleve, termocentraleve apo impianteve te cilat bejne te mundur shfrytezimin e energjise qe gjenden ne natyre dhe qe jane te rinovueshme. Shitja e energjise elektrike klienteve dhe blerja e energjise elektrike nga operatore te ndryshem privat apo shteteror brenda dhe jashte vendit. Transmetirni i energjise elektrike ne sistemin e tensionit te larte, funksion i cili perfshin transmetimin ose interkonjeksionin nderkombetar. Perdorimin e sistemeve te linjave, strukturave mbeshtetese dhe pajisjesh, transformuese e kontrolluese per transmetimin e energjise elektrike. Operator i sistemit te transmetimit te energjise elektrike dhe te dispecerimit 2 (axhustim ose rregullimi i prodhimit te energjise elektrike ne nivel kombetar. Shperndarjen, transportin e energjise elektrike ne sisternet shperndarese te tensionit, te mesem dhe te ulet, duke patur parasysh shperndarjen deri tek konsumatori i fundit. Shoqeria mund te bashkepunoje dhe/ose te marre direkt ose indirekt interesa, ne shoqeri, firma, agjenci dhe ndermarrje te tjera, te cilat mund te kene edhe qellime te tjera aktiviteti. Import makinerish industriale qe dote bejne te mundur kryerjen dhe realizimin e objektit te kompanise. Shoqeria ka per objekt kryerjen e cdo veprimtarie te lejuar nga ligji dhe /ose pjesemarrjen ne cdo veprimtari apo aktivitet te ligjshem qe mund te kryej nje shoqeri ne baze te legjislacionit shqiptar. Shfrytezim, perpunim, te lendes drutesore, punime auto pyjore, dhe ripertitje pyjesh. Punime ne ndertimin e kanaleve kulluese, pasurive te paluajtshme, drenazhime prita, rruge dytesore etj.
- Implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese të energjisë elektrike eolike, fotovoltaike, hidrike dhe gjeotermale në territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe marrja nga Qeveria Shqiptare apo Institucionet e Shtetit Shqiptar i të gjitha lejeve dhe licencave të cilat mundësojnë zhvillimin e këtij aktiviteti në mënyrë të qetë dhe në përputhje me kuadrin ligjor në Republikën e Shqipërisë. Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çdo lloj aktiviteti të parashikuar nga ligji në përputhje me rregullat e dispozitat në fuqi. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në bazë të autorizimeve dhe/ose lejeve përkatëse të lëshuara nga organet kompetente të fushës.

- Investime ne fushen e energjise dhe ndertim (ere, termocentral, hidrocentral, biomase dhe dielli dhe format e tjera te energjise), tregti, eksport import, investim-ndertim dhe prodhim, eksport-import ne miniera, investim-ndertim ne rruge, ura, hekurudha, aeroporte, etj. Import eksport, tregtim me shumice dhe pakice te mallrave te ndryshme industriale. Prodhim dhe tregtim materiale ndertimi dhe inertesh, si dhe cdo veprimtari tjetër te parashikuar nga ligji shqiptar.

Neni 3

Kohëzgjatja e Shoqerise

Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë e pakufizuar duke filluar nga dita e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Neni 4

Selia dhe Adresa Elektronike

1. Selia e Shoqërisë “**ATLAS FABIANNE**” **SHA**, ndodhet ne adresën: Tiranë, Farkë, Selitë, Rruga “Selita e Vjetër”, Ndërtesa me Nr. Pasurie 124/36+1-17, ZK.3292, Tirane.
2. Adresa e Shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon infofabianne@yahoo.com

Kreu II

Kapitali


Neni 5

Kapitali themeltar

1. Kapitali i regjistruar i shoqërisë eshte 3.500.000 leke.
2. Kapitali aksionar i shoqerise eshte ndare ne 100 aksione te zakonshme me nje vlere nominale 35.000 leke secili.
3. Aksionari themelues i Shoqerise, Z.Ben Petani, zoteron 100 % te aksioneve me vlere nominale prej 35.000 leke secili.
4. Cdo aksion i zakonshem i jep zoteruesit te tij te drejta vote ne raport proporcional me pjesen e kapitalit qe perfaqeson aksioni.
5. Aksionari ka shlyer 1/4 e vleres se kapitalit te nenshkruar ne menyre proporcionale me pjesemarrjen ne Shoqeri ne llogarine e Shoqerise sic parashikohet ne ligj dhe do vijoje te shlyje vlerat perkatese sipas dispozitave ligjore dhe Statutit.

Neni 6

Kërkesa për të paguar aksionet



1. Administratorët mund t'u kërkojnë aksionarëve pagimin e kontributeve të pashlyera në lidhje me aksionet e tyre dhe çdo aksionar. Njoftimi për pagesë mund të parashikojë shlyerjen me këste të kontributeve të papaguara. Personi të cilit i drejtohet njoftimi për pagesën e kontributit do të jetë përgjegjës për njoftimet që i drejtohen atij pavarësisht kalimit të mëposhëm të pronësisë së aksioneve me të cilat lidhet njoftimi për pagesë.
2. Zotëruesit e përbashkët të një aksioni do të jenë përgjegjës bashkërisht dhe në mënyrë solidare për shlyerjen e kontributeve, sipas njoftimit të mësipërm.

Neni 7

Llojet dhe kategoritë e aksioneve

1. Aksionet mund të jenë të zakonshme ose aksione me përparësi. Aksionet e zakonshme u japin zotëruesve të tyre tagër për të ushtruar në asamblenë e përgjithshme të drejtat e aksionarit dhe për të përfituar pjesë të fitimeve dhe të shpërndarjes së pasurive të mbetura pas likuidimit, në raport me pjesën e kapitalit që aksionet e tyre përfaqësojnë. Aksionet me përparësi u japin zotëruesve të tyre tagrin që nga ndarja e dividendëve të vendosur nga asambleja e përgjithshme të përfitojnë një shumë të caktuar ose një përqindje të caktuar të vlerës nominale të aksioneve të tyre, përpara shpërndarjes së fitimeve, në favor të aksionarëve të zakonshëm, përparësi në ndarjen e pasurive të shoqërisë, të mbetura pas likuidimit dhe të drejta të tjera të përcaktuara me ligj apo në statut.
2. Shënimi në statut i përparësive, që rrjedhin nga zotërimi i këtyre aksioneve, prezumohet shterues.
3. Aksionet, që japin të njëjtat të drejta, përbëjnë aksione të së njëjtës kategori (aksione të zakonshme, aksione me përparësi, aksione me të drejtë vote dhe aksione pa të drejtë vote).

Neni 8

Regjistri i aksioneve

1. Shoqëria aksionare mban një regjistër të posaçëm, ku regjistrohen të dhënat e zotëruesve të aksioneve të shoqërisë, si: emri e mbiemri i aksionarit, apo emri i regjistruar, nëse është person juridik, vlera nominale e aksionit, adresa e banimit apo zyra qendrore e aksionarit dhe data e kryerjes së regjistrimit.
2. Administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e regjistrit të aksioneve të shoqërisë e detyrohen të lejojnë aksesin në informacionet e regjistrit ndaj çdo aksionari apo çdo personi tjetër që e kërkon. Informacioni i regjistrit të aksioneve duhet të publikohet në faqen e shoqërisë në internet. Shoqëria mund të lejojë regjistrimin *on-line* të të dhënave, që duhen regjistruar sipas pikës 1 të këtij neni. Administratori është i ngarkuar me detyrën e mbajtjes së regjistrit të aksioneve.
3. Administratori i Shoqërisë **“ATLAS FABIANNE” SH.A.** do të jete **Z.Ben Petani** për një afat 3 (tre) vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

Neni 9

Menyrat e fitimit dhe kalimit të Aksioneve

1. Aksionet e një shoqërie aksionare dhe të drejtat, që rrjedhin prej tyre, mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë, në çastin e formimit të shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - ç) dhurimit;
 - d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
2. Aksionet e të drejtat e fituara si më sipër nuk mund të ushtrohen ndaj asnjë personi apo ndaj shoqërisë, përpara se veprimi të jetë regjistruar në regjistrin e posaçëm të aksioneve, që mban shoqëria, në përputhje me pikën 1 të nenit 119 të këtij ligji.
3. Në rastet e kalimit të aksioneve me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi aksionin, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshi momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata për kalimin e aksionit hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përbën kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës. Transaksionet në formë elektronike, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9879, datë 21.2.2008, "Për titujt", konsiderohen të kryera në formë shkresore në përputhje me parashikimet e këtij neni. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palët bien dakord në kontratë, vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi aksionet nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshi këtu formalitetet e regjistrimit a publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit.

Neni 10

Akti i Emetimit të aksioneve

1. Aksionet e shoqërisë emetohen mbi bazën e Aktit të Emetimit, i cili miratohet nga Administratori në lidhje me pjesën e realizuar të zmadhimit të kapitalit aksionar, mbasi të kete hyre në fuqi zmadhimi i kapitalit. Aksionet e reja nuk mund të emetohen dhe të drejtat të lidhura me to nuk mund të transferohen përpara hyrjes në fuqi të zmadhimit dhe miratimit të Aktit të Emetimit.
2. Akti i Emetimit duhet të permbaje të dhënat e kërkuara nga Ligji për Shoqëritë Tregtare.

Neni 11

Transferimi i Aksioneve

1. Aksionet janë të foren nominale dhe lirisht të transferueshme sipas dispozitave të ligjit "Për Shoqëritë Tregtare".

2. Aksionet dhe te drejtat e ftuara si rezultat i transferimit te aksioneve nuk mund te ushtrohen kundrejt Shoqerise apo palëve te treta, përpara se ky transferim te regjistrohet pranë Regjistrimit te Aksioneve.

Neni 12

Zmadhimi i Kapitalit Themeltar

1. Asambleja e Pergjithshme mund te vendose zmadhimin e kapitalit te Shoqerise ne perputhje me kete Statut dhe Ligjin "Per Shoqerite Tregtare", te ndryshuar.
2. Shoqeria do te njoftoje Qendren Kombetare te Biznesit "QKB" per vendimin e miratuar lidhur me zmadhimin e kapitalit aksionar, ne perputhje me afatet e parashikuara nga Ligji Nr.131/2015 per QKB (Qendren Kombetare te Biznesit). Pas perfundimit te nenshkrimet te aksioneve dhe shlyerjes se te pakten nje te tretes se vleres nominale te aksioneve te nenshkruara per kontributet ne para/natyre brenda afateve te kerkuara, Shoqeria do te regjistroje prane QKB zmadhimin e kapitalit te realizuar.
3. Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zmadhohet duke emetuar aksione rishtazi, kundrejt kontributeve të reja. Kur emetohen aksione të reja, këto aksione iu ofrohen aksionarëve ekzistues përpara se t'u ofrohen aksionarëve të tjerë të rinj, në pajtim me nenin 174 të Ligjit. Aksionet e reja iu ofrohen aksionarëve sipas numrit të aksioneve që zotërojnë përpara ofertës. Oferta që iu bëhet aksionarëve ekzistues duhet të pranohet brenda 20 ditësh pas publikimit në QKR.
4. Asambleja e përgjithshme mund të vendosë që zmadhimi i kapitalit të kryhet me emetim të aksioneve të reja, për t'u nënshkruar vetëm nga aksionarët ekzistues. Zmadhimi i kufizuar i kapitalit mund të kryhet vetëm me miratimin unanimit të të gjithë aksionarëve.
5. Zmadhimi i kapitalit me aktivet e shoqërisë. Pas miratimit të bilancit të vitit paraardhës, asambleja e përgjithshme mund të vendosë ta zmadhojë kapitalin e regjistruar, duke kaluar në kapitalin bazë rezervat e disponueshme dhe fitimet e pashpërndara.

Neni 13

Zmadhimi i kapitalit dhe shoqëria me aksionar të vetëm

Shoqëria me aksionar të vetëm mund t'ua ofrojë aksionet e reja personave të tretë e të kthehet në një shoqëri me shumë aksionarë. Ky ndryshim i njoftohet për regjistrim Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 14

Zvogëlimi i kapitalit themeltar

1. Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të asamblesë së përgjithshme, në përputhje me përcaktimet e pikës 1 të nenit 145 të ligjit 9901.
2. Nëse zvogëlimi ndryshon të drejtat e një kategorie të caktuar aksionesh, vlefshmëria e tij kushtëzohet nga pëlqimi i aksionarëve përkatës, i cili duhet të përmbushë kërkesat formale të pikës 3 të nenit 149 të këtij ligji.
3. Zvogëlimi i kapitalit realizohet nëpërmjet zvogëlimit të vlerës nominale të aksioneve dhe anulim aksionesh.
4. Kapitali i regjistruar mund të zvogëlohet nën vlerat minimale, të parashikuara në ligj, vetëm në rastin kur zvogëlimi shoqërohet me një zmadhim të njëkohshëm të kapitalit.
5. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë mbi zvogëlimin e kapitalit themeltar të Shoqërisë. Në rastin kur zvogëlimi i kapitalit nuk është kryer me qëllim mbulimin e humbjeve, Asambleja e Aksionarëve mund të vendosë gjithashtu anulimin e aksioneve, në përputhje me parashikimet e Ligjit për Shoqëritë Tregtare (veçanërisht nenit 149).

Kreu III

Organet e shoqërisë

Neni 15

Organet e shoqërisë

Organet e shoqërisë aksionare "ATLAS FABIANNE" SHA, janë:

1. Asambleja e përgjithshme;
2. Këshilli i Administrimit;
3. Administratori/administratorët.

Neni 16

Asambleja e Përgjithshme

1. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj, e në veçanti nga dispozitat e nenit 148 të ligjit, të drejtat e aksionarëve, për çështjet e lidhura me veprimtarinë e funksionimin e shoqërisë, ushtrohen nëpërmjet asamblesë së përgjithshme.
2. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare;
 - b) ndryshime të statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e anëtarëve të këshillit të administrimit (sistemi me një nivel) të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës e, kur parashikohet në statut, emërimin dhe revokimin e administratorëve;
 - d) ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - e) miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" e "ç" të kësaj pike;

- f) dh) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - g) shpërndarjen e fitimeve vjetore;
 - h) ë) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
 - i) pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;
 - j) ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;
 - k) gj) përfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj organeve të administrimit;
 - l) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - m) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
 - n) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti.
3. Asambleja e përgjithshme merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, së bashku me raportin e këshillit të administrimit apo këshillit mbikëqyrës dhe raportin e ekspertit kontabël të autorizuar.
 4. Nëse shoqëria zotërohet nga një aksionar, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga aksionari i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga aksionari i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet e mëposhtme:
 - a) miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - b) shpërndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimi i hu mbjeve;
 - c) zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;
 - d) ç) vendimet për investime;
 - e) riorganizimi dhe prishja e shoqërisë.
 5. Vendimet e paregjistruara në regjistrimin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 17

Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e përgjithshme mblidhet në rastet e përcaktuara nga ky ligj, nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.
2. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët dhe, në rastet e parashikuara nga ky ligj, nga anëtarët e këshillit të administrimit, të këshillit mbikëqyrës apo nga aksionarët e përcaktuar sipas nenit 139 të këtij ligji.
3. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim, nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik dhe rendi i ditës u dërgohen të gjithë aksionarëve, jo më vonë se 21 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

4. Asambleja e përgjithshme duhet të thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton apo parashikohet qartë se humbjet arrijnë në një vlerë të barabartë me 50 për qind të kapitalit të regjistruar ose që aktivet e shoqërisë nuk mbulojnë detyrimet, që janë të kërkueshme brenda 3 muajve në vijim.
5. Asambleja e përgjithshme duhet të thirret, kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara. Pika 4 e nenit 13 të këtij ligji zbatohet në rastin kur veprimet sipas kësaj pike do të kryhen me personat e përmendur në pikat 2 dhe 3 të nenit 13 të këtij ligji.
6. Asambleja e përgjithshme duhet të thirret, kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit, propozon të blejë, nga një aksionar, pasuri që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
7. Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri 5 të këtij neni, asamblesë së përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar i pavarur.
8. Dispozita e pikës 6 të këtij neni nuk zbatohet nëse blerjet, sipas pikave 4 dhe 5 të këtij neni, kryhen në bursë apo janë pjesë e veprimeve të përditshme të shoqërisë dhe bëhen në kushte normale tregu.
9. Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo kritikuar veprimtarinë e organeve administrative.

Neni 18

Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme vetëm me arritjen e kuorumit të parashikuar nga neni 144 i Ligjit.

Gjatë mbledhjes së asamblesë së përgjithshme përgatitet lista e aksionarëve të pranishëm dhe të përfaqësuesve të tyre, ku shënohen emrat dhe adresat e secilit, së bashku me numrin e aksioneve, numrin e votave, që këto aksione japin, vlerën nominale të aksioneve, si dhe llojin apo kategorinë e tyre, të zotëruara nga secili pjesëmarrës. Kjo listë u vihet në dispozicion aksionarëve dhe përfaqësuesve të tyre dhe nënshkruhet prej tyre.

Asambleja e përgjithshme cakton një kryetar.

Nëse asnjë prej Administratorëve nuk dëshiron të caktohet si Kryetar i mbledhjes ose nëse asnjë prej Administratorëve nuk është i pranishëm për pesëmbëdhjetë minuta duke filluar nga ora e caktuar për fillimin e mbledhjes, aksionarët e pranishëm dhe me të drejtë vote zgjedhin njërin prej tyre si Kryetari të mbledhjes.

Administratori ose anëtari i Këshillit të Administrimit pavarësisht se nuk është aksionar, ka të drejtën e pjesëmarrjes si edhe të marrë fjalën në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme dhe në mbledhjet e veçanta të aksionarëve, zotërues të aksioneve të klasave të ndryshme.

Neni 19

Kuorumi

1. Në rastin e çështjeve, që vendosen me shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse janë të pranishëm ose të përfaqësuar aksionarët, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të aksioneve, me të drejtë vote. Kur asambleja duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 145 të këtij ligji, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse aksionarët, që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të aksioneve me të drejtë vote, apo përfaqësuesit e tyre, marrin pjesë në votim personalisht ose votojnë me shkresë apo me mjete elektronike, sipas parashikimeve të nenit 142 të këtij ligji.
2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 20

Marrja e vendimeve

1. Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tre të katërtat e votave të aksionarëve, që marrin pjesë në votim, sipas parashikimeve të pikës 1 të nenit 144 të këtij ligji, në lidhje me ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj ose në statut, asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e tjera, të renditura në nenin 135 të këtij ligji, me shumicën e votave të aksionarëve, që marrin pjesë.
3. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi aksionarët apo vendimet, që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj, në statut apo në vendime të tjera, kushtëzohet nga miratimi i aksionarit përkatës.

Neni 21

Këshilli i Administrimit

1. Asambleja e Përgjithshme cakton tre ose më shumë, por jo më shumë se 21, persona fizikë si anëtarë të Këshillit të Administrimit, në pajtim me shkronjën "c", pika 2 të nenit 135 dhe pikën 2 të nenit 155 të Ligjit. Emërimet do të jenë individuale dhe në përputhje me vendimin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicë votash, i cili, nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si anëtar të Këshillit të Administrimit. Anëtarët e Këshillit të Administrimit mund të shkarkohen nga detyra në çdo kohë nga Asambleja e Përgjithshme, pa cenuar të drejtat që burojnë nga një kontratë pune e lidhur me Shoqërinë.
2. Shumica e anëtarëve të Këshillit të Administrimit do të jenë të pavarur dhe nuk do të jenë Administratorë, në përputhje me parashikimet e pikës 1 dhe 4 të nenit 155 të Ligjit.

3. Anëtarët e Këshillit të Administrimit mund të caktojnë një person i cili dëshiron të veprojë në cilësinë e anëtarit të Këshillit të Administrimit, duke pasur parasysh se emërimi nuk përbën zmadhim të numrit të anëtarëve, të përmendur në pikën 1 të këtij neni. Anëtari i Këshillit të Administrimit i emëruar në këtë mënyrë do të jetë në detyrë deri në mbledhjen vjetore vijuese të Asamblesë së Përgjithshme.
4. Personat e mëposhtëm emërohen si anëtarë të parë të Këshillit të Administrimit të Shoqërisë deri në zgjedhjen e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme, sipas shkronjës “c”, pika 2 të nenit 135 të Ligjit.

Personat e mëposhtëm emërohen si anëtarë të parë të Këshillit të Administrimit deri në zgjedhjen e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme:

1. **Andrea Qose**, shtetas Shqiptar, i datëlindjes 18.09.1950, mbajtës i kartës së identitetit me nr.036484740 dhe nr. Personal F00918022O, banues në Tiranë me adresë, Rruga “Besim Fagu”, Pallati Nr.4, Njesia Administrative Nr.4 Tiranë.
2. **Emanuela Bilçari**, shtetase shqiptare, e datelindjes 20.04.1992, mbajtëse e kartës së identitetit me nr.036872400 dhe nr. Personal J25420001D, banuese në Tiranë me adresë, Rruga “Ali Demi”, Pallati Nr.141, shkalla Nr.7, Tiranë.
3. **Stela Shulla**, shtetase shqiptare, e datelindjes 22.08.1986 mbajtëse e kartës së identitetit me nr.032326757 dhe nr. Personal I65822056L, banuese në Tiranë me adresë, Rruga “Frosina Plaku”, Kompleksi “Homeplan”, shkalla Nr.2, Ap 262, Tiranë.

Neni 22

Te drejtat dhe detyrimet e Këshillit të Administrimit

1. Këshilli i administrimit ka këto të drejta dhe përgjegjësi:

- a) të japë direktiva për administratorët për zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratorët;
- c) të përgatisë, me kërkesë të asamblesë së përgjithshme, marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e asamblesë;
- ç) të thërrasë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;
- d) të kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;
- dh) të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;
- e) të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo

statutit, të kryhen me saktësi nga administratorët. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë e anëtarët e këshillit të administrimit për t'iu paraqitur asamblesë së përgjithshme, së bashku me një raport të këshillit të administrimit për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;

ë) të sigurojë se auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur e raporti i auditimit, drejtuar asamblesë së përgjithshme, t'u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të këshillit e administratorëve. Raporti i këshillit të administrimit, përmendur në shkronjën "e" të kësaj pike, duhet të përmbajë edhe mendimin për raportin e auditimit;

f) të emërojë dhe të shkarkojë administratorët, të ndajë kompetencat ndërmjet tyre;

g) të përcaktojë shpërblimin e administratorëve;

gj) të miratojë marrjen përsipër të detyrimeve me vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare, të certifikuara, nëpërmjet nënshkrimit të huave apo emetimit të obligacioneve apo instrumenteve të tjera të borxhit;

k) të vendosë krijimin e bashkëpunimeve tregtare afatgjata dhe propozimin e politikave, për themelimin e shoqërive tregtare ose të grupeve të reja;

i) të kryejë veprimet e tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.

2. Në rastet e parashikuara në pikat 3, 4 e 5 të nenit 136 të këtij ligji, këshilli i administrimit duhet të thërrasë menjëherë asamblenë e përgjithshme, për të shqyrtuar nëse shoqëria duhet të priset ose për marrjen e masave të tjera të nevojshme e të përshtatshme.

Neni 23

Mbledhjet e Këshillit të Administrimit

4. Mbledhjet e Këshillit të Administrimit do të mbahen të paktën dy herë në vit sipas nevojave të aktivitetit tregtar të Shoqërisë, derisa Asambleja e Përgjithshme të vendosë me shumicë të zakonshme votash mbi shpeshtësinë e mbledhjeve të Këshillit të Administrimit.
5. Vendimet e Këshillit të Administrimit merren me kuorumin e përcaktuar në nenin 162 të Ligjit. Anëtarët e Këshillit të Administrimit mund të marrin pjesë në mbledhje nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit përfshirë komunikimin video dhe audio konferencë. Ata mund të marrin pjesë në votime duke përdorur numrin PIN të lëshuar çdo anëtarë në momentin e emërimit.
6. Anëtarët e Këshillit të Administrimit emërojnë njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes, i cili mund të shkarkohet në çdo kohë nga kjo detyrë. Administratori nuk mund të emërohet si Kryetar i Këshillit të Administrimit. Kryetari do të drejtojë çdo takim të Këshillit të Administrimit në të cilin ai është i pranishëm. Në rast se Kryetari nuk dëshiron të drejtojë mbledhjen apo nuk është i pranishëm brenda pesë minutave nga orari i caktuar për mbledhjen, anëtarët e Këshillit të Administrimit mund të emërojnë njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.
7. Çështjet e rendit të ditës vendosen me shumicën e votave të pjesëmarrësve. Në rast numri të barabartë votash, vota e Kryetarit do të jetë vendimtare.

8. Të gjitha aktet e kryera nga mbledhja e anëtarëve të Këshillit të Administrimit, ose komitetet e anëtarëve të Këshillit të Administrimit, ose nga persona të cilët veprojnë si anëtarë të Këshillit të Administrimit, pavarësisht nëse bëhet e ditur më pas se emërimi i anëtarit të Këshillit të Administrimit ka pasur mangësi ose këta anëtarë janë skualifikuar nga mbajtja e kësaj detyre, ose nuk kishin të drejtë të votonin, do të konsiderohen të vlefshme njëllor sikur këta persona të ishin emëruar rregullisht dhe të ishin cilësuar e të vazhdonin detyrën si anëtarë të Këshillit të Administrimit dhe të kishin të drejtë të votonin në mbledhje.
9. Vendimi me shkrim i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Këshillit të Administrimit që kanë të drejtë të njoftohen për mbledhjen e Këshillit të Administrimit ose të komitetit të anëtarëve të Këshillit të Administrimit do të konsiderohet si i vlefshëm dhe i efektshëm njëllor si të ishte miratuar në mbledhjen e Këshillit të Administrimit ose në komitetin e anëtarëve të Këshillit të Administrimit, të thirrur dhe mbledhur rregullisht.

Neni 24

Procesverbali i Mbledhjes së anëtarëve të Këshillit të Administrimit

Anëtarët e Këshillit të Administrimit do të mundësojnë mbajtjen e procesverbaleve të mbledhjeve në libra të posaçëm për:

1. Të gjithë emërimet e kryera nga anëtarët e Këshillit të Administrimit; dhe
2. Të gjithë mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, mbledhjet e zotëruesve së aksioneve të klasave të ndryshme, dhe mbledhjet e Këshillit të Administrimit dhe komiteteve të Këshillit të Administrimit, përfshirë edhe emrat e anëtarëve të Këshillit të Administrimit të pranishëm në këto mbledhje.

Neni 25

Shkarkimi dhe doreheqja e anëtarëve të Këshillit të Administrimit

1. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë, në çdo kohë, një anëtar të këshillit të administrimit, me shumicë të thjeshtë votash. Kjo e drejtë nuk mund të përjashtohet nga statuti apo me marrëveshje. Paditë, që lidhen me shpërblimin e anëtarit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.
2. Anëtari i këshillit të administrimit, i cili është zgjedhur në përputhje me pikën 3 të nenit 155 të këtij ligji, mund të shkarkohet me vendim të aksionarëve të pakicës, që e ka zgjedhur. Kur kushtet e parashikuara në statut për këtë emërim të veçantë nuk janë më në fuqi, asambleja e përgjithshme mund ta shkarkojë anëtarin në fjalë me shumicë të thjeshtë votash.
3. Këshilli i administrimit, me shumicë të thjeshtë votash, mund t'i kërkojë gjykatës përkatëse të shkarkojë një anëtar, nëse ai ka shkelur detyrat e parashikuara në pikën 3 të nenit 163 të këtij ligji.
4. Anëtari i këshillit të administrimit mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar asamblesë së përgjithshme. Anëtari i këshillit të administrimit që jep dorëheqjen, duke pasur parasysh rrethanat veprimtarisë së shoqërisë, është gjithashtu i detyruar të thërrasë asamblenë e

- përgjithshme për emërimin e anëtarit të ri të këtij këshilli, përpara datës kur dorëheqja të hyjë në fuqi.
5. Nëse asambleja e përgjithshme nuk vendos emërimin e anëtarit të ri të këshillit të administrimit në datën e përcaktuar në thirrjene kryer nga anëtari i dorëhequr, atëherë administratori apo, në mungesë apo mosveprim të tij, anëtari i dorëhequr, i njofton me shkrim dorëheqjen Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me kopjen e thirrjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, dhe Qendra Kombëtare të Regjistrimit regjistron largimin e anëtarit të këshillit të administrimit, sipas procedurave të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar.
 6. Dorëheqja e anëtarit të këshillit të administrimit nuk cenon paditë e shoqërisë për shkelje të detyrimit të besnikërisë që anëtari ka ndaj saj, sipas këtij ligji.

Neni 26

Administratorët

1. Këshilli i administrimit emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë, për një afat të përcaktuar në statut, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 3 vjet. Administratorët e shoqërisë mund të rizgjidhen. Anëtarët e këshillit të administrimit mund ta kryejnë detyrën e administratorit për sa kohë shumica e anëtarëve të këshillit të administrimit janë anëtarë të pavarur, që nuk kryejnë këtë detyrë. Emërimi i administratorëve hyn në fuqi në datën e përcaktuar sipas aktit të emërimit. Emërimi mund t'u kundrejtohet palëve të treta, sipas parimeve të nenit 12 të këtij ligji.
2. Administratori i një shoqërie mëmë nuk mund të zgjidhet si administrator i një shoqërie të kontrolluar dhe anasjelltas. Administratori i një shoqërie mëmë nuk mund të jetë kryetar i këshillit të administrimit të një shoqërie të kontrolluar dhe administratori i një shoqërie të kontrolluar nuk mund të jetë kryetar i këshillit të administrimit të shoqërisë mëmë. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është absolutisht i pavlefshëm. Të drejtat e të tretëve mbrohen sipas nenit 12 të këtij ligji.
3. Administratorët kanë të drejtë dhe detyrohen:
 - a) të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
 - b) të përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - c) të kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - ç) të përgatisin dhe të nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilët ia paraqesin këshillit të administrimit për miratim, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, për t'u paraqitur më pas për miratim nga asambleja e përgjithshme;
 - d) të krijojnë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë;
 - dh) të kryejnë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve të këtij ligji apo të ligjeve të tjera;

- e) të raportojnë përpara këshillit të administrimit për zbatimin e politikave tregtare dhe, me realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë, për veprimtarinë e shoqërisë;
- ë) të kryejnë detyra të tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.
4. Detyrat, që i cakton ligji këshillit të administrimit, nuk mund t'u delegohen administratorëve.
5. Në rastet e parashikuara në pikat 3, 4 e 5 të nenit 136 të këtij ligji, administratorët duhet të informojnë menjëherë kryetarin e këshillit të administrimit.
6. Nëse shoqëria emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë shoqërinë në mënyrë të përbashkët. Statuti ose rregulloret, të miratuara nga këshilli i administrimit, mund të parashikojnë ndryshe.
7. Këshilli i administrimit mund t'i shkarkojë administratorët në çdo kohë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e anëtarit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.
8. Administratori, i cili nuk është anëtar i këshillit të administrimit, mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar këtij këshilli. Administratori, duke pasur parasysh rrethanat e veprimtarisë së shoqërisë, duhet të përcaktojë nënjoftimin e shkruar datën në të cilën dorëheqja hyn në fuqi.
9. Nëse këshilli i administrimit nuk vendos emërimin e administratorit të ri përpara datës, në të cilën dorëheqja hyn në fuqi, atëherë administratori i njofton me shkrim dorëheqjen Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, e cila regjistron largimin e administratorit, sipas procedurave të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar.
10. Dorëheqja e administratorit nuk cenon paditë e shoqërisë për shkelje të detyrimeve të besnikërisë që administratori ka ndaj saj, sipas këtij ligji.
11. Në rastet kur administratori është njëkohësisht anëtar i këshillit të administrimit apo kur, sipas pikës 2, të nenit 167, administratori emërohet nga asambleja e përgjithshme, dispozitat e mësipërme të këtij neni, në lidhje me dorëheqjen e administratorit, nuk zbatohen dhe dorëheqja kryhet sipas pikave 4, 5 dhe 6, të neni 157, të këtij ligji.
12. Administratori i Shoqërisë "ATLAS FABIANNE" SH.A. do të jete **Z.Ben PETANI** për një afat 3 (tre) vjeçar me të drejte rizgjedhjeje.

Neni 27

Rregulloret, kryetari dhe komitetet e posacme

1. Statuti ose këshilli i administrimit mund të përcaktojë rregullore për procedurën e funksionimit të mbledhjeve të këshillit, si dhe të marrjes së vendimeve. Vendimet e këshillit të administrimit për këto rregullore merren në mënyrë unanime.
2. Këshilli i administrimit duhet ta zgjedhë kryetarin dhe nënkryetarin e tij, në përputhje me dispozitat e statutit. Nënkryetari ushtron tagrat e kryetarit, kur ky i fundit është në pamundësi për t'i kryer ato personalisht. Një administrator nuk mund të zgjidhet kryetar i këshillit të administrimit.

3. Zhvillimi i mbledhjeve të këshillit të administrimit regjistrohet në një procesverbal, i cili nënshkruhet nga kryetari. Procesverbali përmban vendin dhe datën e takimit, emrat e pjesëmarrësve, rendin e ditës, një përshkrim për çështjet e diskutuara e vendimet e marra. Parregullsitë për mbajtjen e procesverbalit nuk kanë si pasojë pavlefshmërinë e vendimeve të marra. Secili anëtar ka të drejtë të marrë një kopje të procesverbalit.
4. Këshilli i administrimit mund të krijojë komitete të posaçme, të përbëra nga anëtarët e vet, për të përgatitur mbledhjet apo vendimet ose për të mbikëqyrur vënien në zbatim të vendimeve të këshillit, sidomos ato të lidhura me veprimtarinë e administratorëve, shpërblimin e tyre dhe auditimin e librave e të regjistrimeve kontabël. Secili komitet duhet të përbëhet në shumicën e vet nga anëtarë të pavarur, që nuk janë administratorë.

Kreu IV

Dividendët dhe Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar

Neni 28

Dividendët

1. Në përputhje me dispozitat e Ligjit, shoqëria me shumicë të zakonshme të votave së Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë dividendët në përputhje me të drejtat përkatëse të aksionarëve.
2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me aksionet, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumat e paguara për aksionet për të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët pjesëtohen dhe paguhen në përpjesëtim të drejtë me shumat e paguara për aksionet, pjesës ose pjesëve të periudhës për të cilën paguhet dividendi; në rast se aksioni emetohet me kushtin e përfitimit të dividendit nga një datë e caktuar, dividendi do të paguhet në përputhje me këtë kusht.
3. Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një aksion nuk prodhon interesa kundrejt shoqërisë nëse një gjë e tillë nuk parashikohet në të drejtat e aksionit.
4. Çdo dividend që nuk është kërkuar të paguhet brenda dymbëdhjetë vjetëve nga data e maturimit, në rast se vendoset nga Asambleja e Përgjithshme, do të përfitohet nga shoqëria e cila nuk do të jetë më e detyruar që ta paguajë atë.

Neni 29

Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar

Administratorët, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të kualifikuar votash sipas kuorumit të përcaktuar nga neni 145 i Ligjit, mund të vendosë të kalojë në kapitalin themeltar të Shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezerva ligjore ose kapitali.

Neni 30

Eksperti Kontabel

1. Asambleja e Pergjithshme emëron ekspertin kontabël të shoqërisë për çdo vit financiar me kompetencat, por jo vetëm të mëposhtme:
 - Ndihe me mbajtjen e llogarive me qëllim që të jenë në përputhje me parimet kryesore të kontabilitetit.
 - Përgatitja e raporteve vjetore me të dhëna ekonomike (bilancet, llogaritë e fitimit dhe humbjeve dhe dokumente të tjera që lidhen me to) dhe dhënia e mendimeve nëse të dhënat ekonomike reflektojnë gjendjen ekonomike aktuale të shoqërisë.
2. Mandati i ekspertit kontabël është 1 (një) vit, i cili përrputhet me vitin financiar të shoqërisë.
3. Eksperti kontabël i parë i caktuar nga Aksionari Themelues do të jetë, **Shoqëria VENIS - Audit & Financë SHPK**, me NIPT L12005002L.

Kreu V

Prishja dhe njoftimet

Neni 31

Prishja dhe likuidimi

1. Shoqëria aksionare priset:
 - a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
 - b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
 - c) në rast se objekti bëhet i përealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
 - ç) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 i këtij ligji;
 - d) kur, si pasojë e humbjeve ushtrimore, kapitalet e veta të shoqërisë janë në vlerë më të ulët se vlera minimale e kapitalit të regjistruar, të përcaktuar sipas nenit 107, të këtij ligji, apo kur vendoset zvogëlimi i kapitalit të regjistruar të shoqërisë nën këtë vlerë minimale dhe hyrja në fuqi e këtij zvogëlimi nuk kushtëzohet me realizimin e një zmadhimi vijues, nëpërmjet të cilit shoqëria të rikapitalizohet me kontribute të reja me vlerë, të paktën, sa vlera e nevojshme për të arritur kapitalin minimal të përcaktuar sipas atij neni;
 - dh) në raste të tjera, të parashikuara në statut;
 - e) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
 - ë) për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e aksionarëve.
2. Prishja e shoqërisë si pasojë e një apo më shumë prej shkaqeve të përcaktuara në përputhje me shkronjat “a”, “c”, “d”, “dh”, “e” dhe “ë”, të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga asambleja e aksionarëve me shumicën e parashikuar sipas pikës 1, të nenit 145, të këtij ligji.
3. Në rast mosveprimi të asamblesë së aksionarëve për të vendosur prishjen, sipas rasteve të parashikuara nga shkronjat “a”, “c”, “d”, “dh” dhe “e”, të pikës 1, të këtij

neni, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, në çdo kohë, për të konstatuar prishjen e shoqërisë.

4. Pavarësisht nga parashikimet e sipërpër-mendura, ekzistenca e një a më shumë shkaqeve të parashikuara nga shkronjat "a", "c", "d", "dh" dhe "e", të pikës 1, të këtij neni, nukdo të ketë sipasojë prishjen e shoqërisë dhe hapjen e procedurave të likuidimit, nëse përpara vendimit gjyqësor të formës së prerë, të përmendur në pikën 3, të këtij neni, shkak i prishjes është korrigjuar, nëse është e mundshme të korrigjohet, dhe ky korrigjim është publikuar nga shoqëria në regjistrin tregtar, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar.

5. Prishja e shoqërisë, si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën "b", të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente për procedurat e falimentimit, kur, në përfundim të këtyre procedurave, të gjitha pasuritë e shoqërisë janë likuiduar për shlyerjen në mënyrë kolektive të detyrimeve ndaj kreditorëve apo kur gjykata kompetente për procedurat e falimentimit vendos rrëzimin e kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit për shkak të pamjaftueshmërisë së pasurisë së shoqërisë për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit.

6. Prishja e shoqërisë, si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën "ç", të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente, sipas parashikimeve të nenit 3/1 të këtij ligji.

Neni 32

Regjistrimi i prishjes së shoqërisë

1. Administratorët janë të detyruar të regjistrojnë prishjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

2. Nëse prishja bëhet me vendim gjykate, gjykata regjistron vendimin e prishjes ex officio.

Neni 33

Likuidimi në gjendjen e aftësisë paguese

Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë aksionare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, sipas neneve 190 deri në 205 të këtij ligji.

Neni 34

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këto statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet në këto statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 35

Mosmarrëveshjet

Per mosmarrëveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarrëveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Aksionari Themelues i shoqërisë Aksionare “ATLAS FABIANNE” SH.A.

Aksionari i vetem dhe Administratori

Z.Ben Petani

